

TAKIM ME PENSIONISTIN ABDIRREZAK RUSTEMI NGA TETOVA

DODO, BARTËS I MEDALJEVE DHE MIRËNJOHJEVE PUBLIKE DHE PENSIONISTE

Dodo ka tre fëmijë, prej të cilëve dy djem që merren me biznes privat. Për bashkëshorten e tij thotë se është mjeshtre e shkëlqyer ëmbëlsirash, sidomos të tatlisë së njohur tetovare, të cilat i përgatit vetëm me porosi



Kur në mesin e pensionistëve në Tetovë përmendet emri - Dodo, menjëherë vijnë në mendje asociacione për një njeri me shumë mirënjohje, shpërblime dhe sidomos medalje nga garat sportive të pensionistëve. Bëhet fjalë për Abdirrezak Rustemi, emri dhe mbiemri i tij i vërtetë, të cilin pothuajse askush nuk e njeh, përveç nofkës - Dodo. Ai, Abdirrezaku, tashmë është në dekadën e tetë të jetës (i lindur në vitin 1947), ndërsa këtë vit feston një përvjetor të veçantë – 20 vjet në pension (pensionohet në vitin 2005), me 40 vite të plota pune. Në Tetovë, Dodo mund të shihet shpesh me "shokun më të mirë" – biçikletën e tij, ose në klubin e pensionistëve, apo bashkë me ta në fushat sportive.

"Që nga momenti që fitova të drejtën për pension, u aktivizova menjëherë në Shoqatën e Pensionistëve në Tetovë. Më pranuan si sportist në disiplinën tërheqje litari dhe që në vitin e parë ishim më të mirët në garat rajonale, e më pas edhe në ato republikane që i organizon LSHPM. Sigurisht, ai vit ishte i paharruar për mua – për herë të parë fituam medaljen e artë si ekip në garat republikane të pensionistëve. Që atëherë kam fituar gjashtë me-

dalje të arta, shumë medalje të argjenta dhe mirënjohje. Ngjyrat e SHP Tetovë i kam mbrojtur edhe në disiplinën tjetra ku gjithashtu kam fituar medalje", thotë bashkëbiseduesi ynë. Kur bëhet fjalë për mirënjohje dhe shpërblime publike të fituara, Dodo me të vërtetë nuk mund t'i kujtojë të gjitha që ka marrë gjatë jetës. Mirënjohjen e parë e mori kur si anëtar i Klubit Futbollistik "Luboten" u shpall portieri më i suksesshëm në Ligën Rajonale. Ka qenë mes shtyllave edhe si portier i ekipit të Pirokut dhe ka marrë pjesë në themelimin e KF "Shkëndija" në Tetovë, në vitin 1979. Ekipet sportive të SHP Tetovë i ka udhëhequr si trajner, sidomos në tërheqje litari, por edhe në sporte të tjera të përfshira në programin e LSHPM. Në një periudhë të gjatë është besuar edhe roli i gjyqtarit, si në nivel rajonal, ashtu edhe në atë të Lidhjes. "Të gjithë ju njohin dhe ju drejtohen si Dodo. Keni ndonjë shpjegim se çfarë do të thotë kjo?" – e pyesim.

"Është nofka jonë familjare. Është më e vjetër se 400 vjet. Atëherë, një nga paraardhësit tanë e kishte emrin Dodo, dhe që atëherë të gjithë e kemi trashëguar. Ne jemi katër vëllezër dhe pasardhësit tanë,

të gjithë mbajmë këtë nofkë. Në regjistrin e tetovarëve të vjetër, ku janë shënuar emrat e 120 familjeve, familja jonë është në vendin e 40-të. Kjo është krenaria dhe historia jonë. Dua të përmend edhe vëllain tim tashmë të ndjerë, Fejziun, i cili mbante po të njëjtën nofkë dhe ishte aktiv në SHP Tetovë si anëtar i ekipit të dominos, ku ka fituar disa medalje të arta dhe mirënjohje", u shpreh ai.

Dodo ka tre fëmijë, prej të cilëve dy djem që merren me biznes privat. Për bashkëshorten e tij thotë se është mjeshtre e shkëlqyer ëmbëlsirash, sidomos të tatlisë së njohur tetovare, të cilat i përgatit vetëm me porosi. Dodo gjithë jetën e tij punoi në NP "Granit" si shofer, automekanik dhe furnizues. Koleget e tij thonë se është një person shumë pozitiv, mik dhe shok i madh, tipar ky i njerëzve që "sportin" e kanë si profesion të dytë.

Në ndarje, Dodo nuk harroi të premtonte se edhe këtë vit do të marrë pjesë aktivisht në garat sportive të pensionistëve si garues, trajner apo gjyqtar. Na mbetet vetëm t'i urojmë jetë të gjatë, shëndet dhe edhe shumë vite të bukura si pensionist. (Gojko Eftoski)

SHP RADOVISH DHE KONÇE

U festua ditëlindja e 100-të

Të gjithë dëshirojnë të jetojnë sa më gjatë. Kjo dëshirë iu realizua edhe pensionistit Gjorgji Angelov nga Radovishi, i cili së fundmi e festoi ditëlindjen e tij të 100-të. Angelovi ka katër vajza, tetë nipa dhe 14 stërnipër. Vajza më e madhe është 76 vjeç, nipi më i vjetër 50 vjeç, ndërsa stërnipi më i moshuar është 27 vjeç. Ai është martuar për herë të dytë në moshën 92-vjeçare.

Ky ish-polic tashmë është në pension prej 54 vitesh. Edhe pas daljes në pension, ka qenë shumë aktiv. Ka punuar katër dynymë vreshta dhe ka qenë rojtar në Shtëpinë tregtare të Radovishit. Edhe sot, në moshën 100-vjeçare, është vital dhe aktiv.

Ka një oborr të mbjellë me pemë të ndryshme dhe lule, për të cilat kujdeset dhe i mirëmban vetë. I pëlqen të ecë dhe ende mund të shihet nëpër rrugët e qyte-



tit. "Kur zgjohem në mëngjes, bëj gjimnastikë. Mëngjesi im përbëhet nga qumësht dhe dy lugë mjaltë. Deri më tani nuk kam qenë i sëmurë dhe nuk kam qenë te mjeku, përveç një herë kur dola për gjah dhe lëndova këmbën. Që të jetosh më gjatë, duhet të mos i nervozohesh çdo gjëje. Duhet të ushqehesh rregullisht dhe në mënyrë të shëndetshme, si dhe të jesh

sa më aktiv në çdo aspekt, brenda mundësisë tua", thotë xhaxhi Gjorgji.

Me rastin e ditëlindjes së tij të 100-të, përfaqësues të Shoqatës së Pensionistëve të Radovishit dhe Konçes, të udhëhequr nga kryetarja Efterpi Dimitrova, e vizituan këtë pensionist ende vital dhe i dhuruan dhurata simbolike, duke i uruar edhe shumë vite të tjera. Mite Sarbakov.

BISEDË ME INXHINIERIN PYJOR SLOBODAN BEBEKOSKI

Pasuri me bukuri natyrore

Nga "Pyjet Nacionale" të Strugës thonë se sipas tyre, ka prerës të paligjshëm nga Maqedonia, por edhe nga Shqipëria

Maqedonia është një vend i vogël, por i pasur me bukuri natyrore dhe rrallësi. Shumë e quajnë "Perla e Ballkanit". Por, perlat e saj të vërteta janë malet e bukura. Për disa prej tyre, njerëzit kanë krijuar tregime e legjenda që përcillen brez pas brezi. Të tilla legjenda shoqërojnë edhe malin Jabllanicë,



thotë inxhinieri pyjor dhe specialisti për mbrojtjen e pyjeve Slobodan Bebekoski nga fshati Vevčan. Ai ka punuar deri në pensionim në ndërmarrjen SHIK "Jabllanica" në Strugë dhe tashmë është anëtar shumëvjeçar i KE të Shoqatës së Pensionistëve në Strugë.

Për shkak të veprimit të egër të prerësve ilegalë të drurëve dhe zjarrvënësve, vihet në pikëpyetje ekzistenca e bukurive natyrore dhe diversitetit të pasur të këtij rajoni. Banorët e fshatrave nën malin Jabllanicë thonë se çdo ditë janë dëshmitarë të prerjeve ilegale dhe ndezjeve të qëllimshme të pyjeve, gjë që mund t'i lërë ata pa ujë të pijshëm dhe për ujitje. Derisa të shpallet Jabllanica park kombëtar, me florën dhe faunën nën mbrojtje shtetërore, pyjet dhe ekosistemi mund të shkatërrohen plotësisht, duke lënë pas vetëm shpatë të zhveshura dhe rrëshqitje të mundshme të dheut.

"Derisa isha për një periudhë më të gjatë drejtues, një pjesë të madhe të sipërfaqeve të zhveshura dhe rrëshqitjeve i pyllëzova me fidanë të ndryshëm, të cilat sot po priten pa mëshirë nga prerësit ilegalë të drurëve, ndërsa po shkatërrohen edhe nga zjarret", thekson Bebekoski.

Nisma për shpalljen e malit Jabllanicë si park kombëtar është në gjendje stagnimi prej disa vitesh nga pala maqedonase. Ndërkohë, nga ana shqiptare është shpallur dhe mbrojtur. Njohësit thonë se kjo gjendje e vë në rrezik ekzistencën e bukurive natyrore dhe biodiversitetit të pasur të Jabllanicës. Seriozitetin e kësaj situatë e tregojnë edhe banorët e dhjetëra fshatrave përreth Strugës - nga Vishni, Radozhda, Radolishta e deri te fshatrat Jabllanicë dhe Lakavicë, të cilët thonë se prej më shumë se një dekade po shfrytëzohet në mënyrë të pakontrolluar fondi pyjor.

Nga "Pyjet Nacionale" të Strugës thonë se sipas tyre, ka prerës të paligjshëm nga Maqedonia, por edhe nga Shqipëria.

"Në shumë rajone me pyje gështenjash në lokalitetet e fshatrave Oktisi, Vevčan, Podgorcë, Labunishtë - që janë në pronësi private – rrezikohet shkatërimi i tyre për shkak të një paraziti që shkakton kancer në lëvoren e gështenjës. Sipas deklaratave të ekspertëve të NP "Pyjet Maqedonase" dhe disa pronarëve të pyjeve me gështenja, sëmundja është aq e përhapur sa që gjendja shëndetësore e pyjeve me gështenja është tejet e pasigurt, pasi ende nuk është gjetur një mënyrë për ta ndaluar atë. "Sëmundja përhapet shpejt dhe bartet përmes insekteve, shpendëve dhe erës. Pemët fillimisht e humbasin lëvoren dhe më pas thahen plotësisht", thotë inxhinieri pyjor Slobodan Bebekoski. (S. Kukuneshoski)